



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6 i Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/2010) dhe nenit 32 paragrafi 1 i Ligjit për mbrojtje të konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2011), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM

për mënyrën dhe procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes mbi bankat dhe kursimoret në fushën e mbrojtjes të konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 91/2011)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim është përcaktuar mënyra dhe procedura e kryerjes së mbikëqyrjes mbi zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore dhe rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji nga kreditorët mbi të cilët Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore). Banka) kryen mbikëqyrje

Në këtë vendim, nën kreditorët mbi të cilët Banka Popullore kryen mbikëqyrje nënkuptohen bankat dhe kursimoret që kanë leje për themelim dhe punë, të lëshuar nga guvernatori i Bankës Popullore (në tekstin e mëtejme: kreditorët).

II. MËNYRA DHE PROCEDURA E KRYERJES SË MBIKËQYRJES

2. Banka Popullore kryen mbikëqyrje mbi kreditorët përmes:
 - Kontroll të drejtpërdrejt në terren dhe
 - Ndjekja jashtë terrenit, me mbledhjen dhe analizën e raporteve dhe të dhënave të cilat i dorëzojnë kreditorët.

Mënyra dhe procedura e kryerjes së kontrollit të drejtpërdrejtë në terren dhe ndjekja jashtë terrenit të punës së kreditorëve janë përcaktuar me Ligjin për bankat dhe aktet nënligjore përkatëse.

3. Me mbikëqyrjen nga pika 2 e këtij vendimi përcaktohet dhe vlerësohet:
 - harmonizimi i punës së kreditorit me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen

- e Konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore dhe
- zbatimi i rregulloreve të miratuara në bazë të këtij ligji.

4. Banka Popullore gjithashtu mund të zbatojë kontroll të drejtpërdrejtë të punës e ndërmjetësve të kredive të kreditorëve.

5. Shërbimi i auditimit të brendshëm të kreditorit është i detyruar së paku një herë në vit të kryejë auditim të aktiviteteve të kreditorit me ndërmjetësuesit e kredisë dhe përmbushjen e marrëveshjeve të ndërmjetësimit të kredisë . Raporti nga auditimi i kryer duhet të përmbajë së paku të dhëna për llojin dhe vëllimin e aktiviteteve të secilit prej ndërmjetësve të kredisë në periudhën e përfshirë nga auditimi.

Kreditori është i detyruar t'i dorëzojë Bankës Popullore raportet nga auditimet e kryera nga paragrafi 1 i kësaj pike, në afat prej 30 ditësh pas kryerjes së auditimit.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

6. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen edhe në filijalet e bankave të huaja që punojnë në Republikën e Maqedonisë, në pajtim me Ligjin për bankat.
7. Me fillimin e zbatimit të këtij vendimi, pushon të vlejë Vendimi për mënyrën dhe procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes mbi bankat dhe kursimoret në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve gjatë marrëveshjeve për kredi konsumatore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 105/ 2007 dhe 42/2011).
8. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe do të fillojë të zbatohet nga 01.10.2011.

O nr. 02-15/VII-4/2011
30.06.2011
Shkup

Guvernator dhe kryesues
i këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Димитар Богов